

Performanca e Buxhetit 2018



NË KËTË RAPORT

Periudha raportimit: Janar - Dhjetor 2018

Statusi raportit: Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Bulqizë gjatë vitit 2018 dhe është miratuar në Këshillin Bashkiak

Përmbledhje mbi situatën financiare, të ardhurat, shpenzimet sipas programeve si edhe rezultatet kryesore të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Bulqizë me asistencën e Projektit "Bashki të Forta". Për më shumë informacion në lidhje me të kontaktoni me Z.Rustem Bici në adresën bicirustem@yahoo.com

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME




Popullsia: Censuri (2011) 32.210 banorë
 Rregjistri Civil 40.223 banorë
 Sipërfaqja: 678.51 km²
 Dendësia: Censuri (2011) 47.47 banorë/km²
 Rregjistri Civil 59.28 banorë/km²

Nëndarjet Administrative: 8

(1) Bulqizë (2) Martanesh (3) Fushë-Bulqizë (4) Zërqa (5) Shupenzë (6) Gjoricë (7) Ostren (8) Trebisht

Rezultatet në zgjedhjet vendore të vitit 2015 si më poshtë:



Shpërndarja e anëtarëve:



EKZEKUTIVI Numri i përgjithsëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Bulqizë për zgjedhjet vendore të vitit 2015 ishte 29.065 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 58.4%. Këshilli bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë të grupuar midis partive politike PS, PD, LSI, PR, PDM, AAK dhe PDS.

Kryetari i Bashkisë është **Z.Melaim Danzi**.


EKONOMIA Relievi kodrinor-malor përcakton si burime kryesore gjeneruese bujqësinë dhe blegtorinë, por pa harruar edhe industrinë e nxjerrjes së kromit dhe atë të pasurimit të mineralit të kromit, ku rajoni i Bulqizës është mjaft i njohur. Ndërkohë, një tjetër burim i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të këtij rajoni konsiderohet edhe turizmi malor familjar si dhe ngritja e qendrave për grumbullimin e bimëve medicinale, me të cilat zona është mjaft e pasur.

Qyteti i Bulqizës, i ndërtuar në funksion të minierës së kromit dhe rezervave të mëdha të kromit ka një numër të konsiderueshëm biznesesh, ndërsa numri i të punësuarve në minierë si dhe përfitimet ekonomike nga punësimi kanë variuar gjatë dekadave të fundit. Në disa raste, miniera është mbyllur duke rritur papunësinë, ndërsa në periudha të tjera ka pasur kërkesa më të larta për punësim.

SITUATA FINANCIARE

- ⇒ Bashkia ka përmirësuar menaxhimin e financave publike.
- ⇒ Bashkia ka arritur arritur të shpenzojë 100% të ardhurat për vitin 2018, normë kjo e cila ka arritur duke u rritur nga viti në vit.
- ⇒ Detyrimet e prapambetura janë ulur nga viti në vit në sajë të kujdesit të treguar në administrimin e shpenzime.

Fact 2015, 2017, 2018



BUXHETI 2018


Burimet e financimit planifikimi 2018

- ⇒ Transferta e pakushtëzuar (granti)
- ⇒ Transferta specifike
- ⇒ Të ardhurat nga burimet e veta
- ⇒ Të ardhura të trashëguara nga viti 2017,
- ⇒ Transferrat e kushtëzuara

Buxheti për vitin 2018 = 922.730 mijë lekë

Shërbimet kryesore të ofruara dhe financuara nga bashkia


- | | |
|--|------------------------------------|
| ⇒ Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme | ⇒ shumë sportet |
| ⇒ Ujitje e kullimi | ⇒ Kultura dhe Turizmi |
| ⇒ Agjensia e Bujqësisë dhe shërbimi pyjor | ⇒ Arsimi parashkollor dhe 9 vjeçar |
| ⇒ Agjensia e rrugëve | ⇒ Arsimi i mesëm dhe konviktet |
| ⇒ Shërbimet bashkiake | ⇒ Shërbimi zjarrfikës |
| ⇒ Shërbimi Ujësjiellës kanalizime | ⇒ Fondi rezerve dhe i kontigjences |
| ⇒ Çerdhet | ⇒ QKB |
| ⇒ Sporti dhe | ⇒ Gjendja Civile |
| | ⇒ Ndihma ekonomike dhe paaftësia |



Buxheti faktik për vitin 2018 = 710.426 mijë lekë

TË ARDHURAT 2018

Burimet e Financimit (në mijë lek)



Burimi: Bashkia Bulqizë, FPT 2019-2021



Rritja ne %	2017	2018
Te ardhura nga burimet e veta	31.51	(8.49)
Transferta e pakushtezuar	3.57	6.85
Transferta e kushtezuar	(17.43)	(36.17)
Transferta specifike	88.82	(7.04)
Trasheguar nga viti i kaluar	17.90	(8.77)
Total	17.69	(7.56)

Burimi: Bashkia Bulqizë, FPT 2019-2021


SHPENZIMET

Bashkia Bulqizë i kushton vëmendje gjithnjë e më shumë në rritje shërbimeve sociale, administrimit dhe shërbimeve publike.

Programet buxhetore më të financuara gjatë vitit 2018, që përbëjnë rreth 80% të buxhetit janë:


- A. Mbrojtja Sociale
- B. Planifikim, Menaxhim, Administrim
- C. Shërbime Publike dhe Gjëndja Civile
- D. Arsimi bazë dhe parashkollor

% ndaj totalit te Buxhetit, 2018



Programi me realizimin më të lartë është "Mbrojtja Sociale", kurse "Rrugët Rurale" ka realizimin më të vogël krahasuar me planifikimin

Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore



TREGUESIT E PERFORMANCËS

Rezultatet vjetore të treguesve të performancës buxhetore



Bashkia ka rritur performancën e përdorimit të fondeve buxhetore. Kjo rritje ka ardhur edhe në sajë të rritjes së transparencës së vendimarrjes bashkiake.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak kanë qenë të hapura dhe pjesa më e madhe e vendimeve që detyrojnë konsultimin me publikun janë diskutuar paraprakisht me banorët.

Disa arritje të rëndësishme të përmirësimit të shërbimeve ofruar komunitetit vendor falë rritjes jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të kapaciteteve njerëzore të bashkisë janë renditur më poshtë, tregues performance sipas programeve.

PROGRAMI

UJI I PIJSHËM DHE KANALIZIMET

Objektiva

Rritja e shërbimit cilësor ndaj popullatës

Bashkia mbulon më shumë se 76% të popullatës me shërbimin e ujit të pijshëm.

Bashkia ka përmirësuar administrimin e të ardhurave nga tarifa e këtij shërbimi dhe arrin të mbledhë rreth 80% të faturimeve të këtij shërbimi duke mbuluar rreth 88% të kostove operative dhe të mirëmbajtjes të UK-së.

Ofrimi i ujit të pijshëm është rreth 7 orë ujë të pijshëm në ditë - natë, shërbim i cili ka nevojë për përmirësim. Bashkia po punon për hartimin e një plani të integruar për menaxhimin dhe largimin e ujërave të zeza.

Shërbimi ofrohet nga njëسيا e shërbimit të bashkisë. Uji i pijshëm ofrohet nga njëسيا e shërbimit të bashkisë e cila ka shpenzuar një fond prej 78.5 milionë lekësh gjatë vitit 2018 e gjitha për investime në fshatrat e bashkisë.

Për mirëmbajtjen dhe shërbimin e kanaleve sanitare bashkia ka 9 punonjës dhe ka shpenzuar rreth 9 milionë lekë gjatë vitit 2018

Realizimi i shpenzimeve : 53% e vlerës së parashikuar (69.886 mijë lekë, 39% e buxhetit të investimeve)


TREGUES

PERFORMANCE


Treguesit e performancës së këtij shërbimi për bashkinë janë:

- ◆ **TP 1.** % e popullatës e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm
- ◆ **TP 2.** % kostos operative të shërbimit e mbuluar nga tarifa
- ◆ **TP 3.** % e kostos totale të shërbimit e mbuluar nga tarifa
- ◆ **TP 4.** Orë ujë i pijshëm furnizuar në ditë natë
- ◆ **TP 5.** Norma e arkëtimit të tarifave

Kohëzgjatja e furnizimit me ujë të pijshëm (orë në ditë)



Shërbimi ujit të pijshëm dhe kanalizimeve 2015-2018



PROGRAMI

MENAXHIMI I MBETJEVE BASHKIAKE

Objektivi i programit
Krijimi i një mjedisi të
pastër

Bashkia mbulon rreth 70% të territorit me shërbimin e grumbullimit dhe transferimit të mbetjeve urbane. Ky shërbim ofrohet për 5.200 familje dhe për 550 biznese. Shërbimi i pastrimit ofrohet një herë në ditë në 70% të territorit dhe dy herë në ditë në 50% të territorit.

Shërbimi ofrohet nga vetë njësia e shërbimit të bashkisë e cila ka 17 punonjës me kohë të plotë. Bashkia ka shpenzuar rreth 15 milionë lekë për këtë shërbim gjatë vitit 2018 i cili zë rreth 2% të buxhetit.



PROGRAMI

SHËRBIMI I BORXHIT

Objektivi i programit

Bashkia respekton detyrimet ndaj të tretëve


Bashkia ka detyrime të papaguara kundrejt të tretëve.

Kryesisht këto detyrime janë fonde për investime që nuk i janë shlyer sipas kontratës së zbatimit të projekteve nga kompanitë private.

Gjatë vitit 2018 bashkia ka shlyer rreth 28% të detyrimeve, duke vendosur objektiva shumë ambiciozë për ti shlyer tërësisht borxhet deri në fund të vitit 2019.



Borxhi akumuluar (në mijë Lekë)



PROGRAMI

SHËRBIME TË PËRGJITHSHME

Objektivi i programit

Ulja e procedurave
burokratike të
administratës vendore

*Realizimi i shpenzimeve : 66% e
vlerës së parashikuar (52.284 mijë
lekë, 7% e buxhetit)*

Tregues performance

- ◆ **TP 1.** Koha e pritjes për marrjen e një certifikate (në minuta)

Bashkia Bulqizë punon për të përmirësuar shërbimin ndaj komunitetit përmes identifikimit të mekanizmave dhe institucioneve përgjegjëse për përcaktimin e zgjidhjeve të duhura për modernizimin e shërbimit të gjendjes civile, ndërtimit të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile si edhe ndërtimin dhe implementimin e sistemit të adresave.

Shpenzimet për gjendjen civile zënë rreth 1% të buxhetit të bashkisë

ndërkohë që bashkia e ka realizuar planin plotësisht sipas parashikimeve për vitin 2018.

Arritjen e objektivave të këtij shërbimi bashkia e mat nëpërmjet kohës së pritjes për të marrë shërbim nga zyrat e gjendjes civile.

Rezulton se mesatarisht qytetarët kanë pritur jo më shumë se 5 minuta për të marrë shërbim nga sportelet e bashkisë.



PROGRAMI

INFRASTRUKTURA RRUGORE—RRUGËT RURALE

Objektivi i programit

Përmirësimi
infrastrukturës rrugore
dhe lëvizshmërisë

*Realizimi i shpenzimeve : 44% e
vlerës së parashikuar (31.975 mijë
lekë, 5% e buxhetit)*

TREGUES PERFORMANCE:

Bashkia kujdeset për mirëfunksionimin e infrastrukturës rrugore duke shtuar rrugë të reja mirëmbajtjen e atyre ekzistuese, dhe linjave të transportit publik.

Gjatë vitit 2018 bashkia ka shpenzuar mbi 55 milionë lekë për këtë funksion nga të cilat rreth gjysma e tyre (27 milionë lekë) kanë shkuar për investime. Për mirëmbajtjen e rrugëve rurale bashkia ka 21 punonjës.

Treguesit e performancës së këtij shërbimi është rrjeti rrugor urban dhe rural i shtuar apo mirëmbajtur. Gjatë vitit 2018 bashkia ka shtuar dhe mirëmbajtur rreth 140 km rrugë rurale dhe 3.5 km rrugë urbane.

- ◆ **TP 1. Përmirësimi i rrugëve urbane** (rrugë të reja dhe / ose të mirëmbajtura) në Km
- ◆ **TP 2. Përmirësimi i rrugëve rurale** (rrugë të reja dhe / ose të mirëmbajtura) në Km²



PROGRAMI

NDRIÇIMI I RRUGËVE

Objektiva

Rritja e sigurisë së komunitetit nëpërmjet ndriçimit të hapësirave publike

TREGUES PERFORMANCE

- ◆ **TP1.** RITJA E SIPërFAQES SË NDRIÇUAR NGA NJËRI VIT NË TJETRIN
- ◆ **TP2.** ORË NDRIÇIMI NË VIT
- ◆ **TP3.** NUMRI I NJËSIVE ADMINISTRATIVE QË MARRIN NDRIÇIM TË RRUGËVE NGA BASHKIA

Bashkia mbulon me ndriçim rreth 25 mijë metra katrorë rrugë dhe sheshe publike.

Gjatë vitit 2018 bashkia ka shpenzuar rreth 6.2 milionë lekë për të ndriçuar mesatarisht 10.5 orë gjatë natës këto rrugë dhe sheshe publike.

Bashkia ka 2 punonjës me kohë të plotë të cilët sigurojnë që ky shërbim të realizohet më së miri.

